

NDËRTIMI INSTITUCIONAL NË KOSOVË (1989-1999) - RASTI I VITISË, SAMET DALIPI, “DANI”, VITI, 2024

Samet Dalipi, mësimdhënës pranë Kolegjit “UNI-Universum International College”, është një emër i shquar, i cili gjithë potencialet e tija i ka vuri në shërbim të çështjes kombëtare të shqiptarëve të Kosovës. Si një intelektual prej aktivisti për lirinë, çlirimin, pavarësinë dhe ndërtimin në praktikë të idesë së shtet-ndërtimit të Kosovës, Dr.Samet Dalipi, na del në pah si aktivist i shquar qysh në fillim të viteve '90 të shekullit XX, kur në Kosovë nisen vllimet e mëdha politike dhe udhëheqësit e Kosovës, të shtyre nga vullneti sublim i popullit tonë dhe historia e popullit shqiptar të Kosovës, nisen rrugëtimin e gjatë, i cili në fund do të jetësohet me lirinë, çlirimin dhe pavarësinë e Kosovës.

Rrugëtimi i shqiptarëve të Kosovës, për shtet të pavarur dhe sovran, ka qenë një rrugëtim i gjatë, me shumë sfida e mbi të gjitha tepër sakrifikues, i cili nuk është ndalur qysh nga vitit 1912, kur Kosova do të mbetet nën pushtimin dhe pushtetin e Serbisë, rruge e cila do të kurorëzohet më 1999, kur Kosova do të çlirohet fal sakrificë së shumë brezave, lëvizjes paqësore të Presidenti historik Dr.Ibrahim Rugova, luftës çlirimtare të viteve 1998-1999 dhe ndërhyrjes së aleancës së NATO-së në kryer më Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Samet Dalipi, duke i takuar një plejade të intelektualeve vitias, i cili qysh në fillim viteve '90 do të i bashkohet Lëvizjes gjithë-popullore për liri, çlirim e pavarësi të prirë nga Dr.Rugova, ai në vitin 1992, do të marr mbi supet e veta barrën e drejtimit të Lidhjes Demokratike të Kosovë dega në Viti, dhe kështu bashkë me shumë veprimtarë e veprimtare, do të nisin rrugëtimin e sakrificës për ndërtimin e institucioneve të pavarura të Republikës së Kosovës, republikë kjo e shpallur me 02 korrik 1990, e nisur së ndërtuari në një situata të brishtë të politikës në Evropë e botë, por kjo nismë do të merr jetësimin e saj edhe me miratimin e Kushtetutës së Republikës së Kosovës me 07 shtator të vitit 1990 në qytetin e Kaçanikut, e nisur së zbatuari në Deçan

sipas vendimeve të Mbledhjes së Isniqit të 10 tetorit 1990, e pasuar me pas më Referendumin gjithë-popullor për Kosovën shtet të pavarur dhe sovran (shtator 1991), zgjedhjet e para shumë partiake për Kuvendin dhe Presidencën e Kosovës (maj 1992).

Libri: “Ndërtimi institucional në Kosovë (1989-1999) - rasti i Vitisë” i autorit Dr.Samet Dalipi, është një libër me rendësi shkencore, i cili ka të përmbledhur në të pothuajse të gjitha zhvillimet politike, që tashme kanë kaluar në faqet e historisë së Kosovës, të cilat e kanë karakterizuar historinë e Kosovës në përgjithësi, e posaçërisht atë të Komunës së Vitisë në veçanti.

Libri i Dr.Dalipit, është një prurje me vlere për historinë e ndërtimit të institucioneve të Kosovës në përgjithësi dhe për historinë e popullit shqiptar në veçanti, ngase është një ofrues i të dhënave të cilat sipas mendimit tonë dalin nga dora e parë dhe të cilat janë shtjelluar, trajtuar pas hulumtimeve të detajuara që Dr.Sameti i ka realizuar për të hedhur në dritë një nga periudhat me të shndritshme të historisë sonë kombëtar.

Libri: “Ndërtimi institucional në Kosovë (1989-1999) - rasti i Vitisë” i autorit Dr.Samet Dalipi, është i ndërtuar në tete kapituj, të cilët të ndarë në njësi të veçanta ofrojnë të dhëna me rendësi dhe peshe për zhvillimet politike në nivel Kosove, si dhe në nivelin e organizmit në Viti dhe rrethinë. Ajo çka e bene me të veçantë librin e Dr.Dalipit, është së ofrimi i të dhënave për zhvillimet politike, arsimore, financiare, shëndetësore, organizatave shoqërore, diasporës, organizimet në nivel të fshatrave, sporti dhe kultura, janë një gërshetim me rendësi i cili do të jetë bazament për historianët e rinj të cilët shprehin gatishmërinë për të bere trajtime për historinë e kësaj zonë të Kosovës.

Libri: “Ndërtimi institucional në Kosovë (1989-1999) - rasti i Vitisë” i autorit Dr.Samet Dalipi, është një libër me vlere të veçante dhe do të jete si përmendore e kujtesës sonë kolektive për brezat që do të vinë se sa e gjatë dhe vështire ishte lufta e jonë për lirinë, çlirim, pavarësinë dhe ndërtimin e institucioneve të Republikës së Kosovës. Natyrshëm, që historia e një populli nuk mund të ndërtohet mbi narracionet imagjinare, dhe ky libër është një kundër argument i narracioneve fantome të përpjekjeve të qarqeve të caktuara për të sulmuar apo abroguar elemente të caktuara të historisë sonë kombëtare të periudhës 1989-1999.

Në fund të këtij mendimin profesional, duka të theksoj një paragraf të cilin e potencoj pothuajse në çdo mendim rreth historisë së Kosovës se periudhës 1912-1999 se: *“Respektimi i vlerave historike dhe i të kaluarës sonë të përbashkët, është dëshmia më e mirë, për të nderuar të gjithë ata që dhanë kontribut në ndërtimin e shtetit tonë, Republikës së Kosovës. Me këtë dua të them, së Ushtria Çlirimtare e Kosovës, Lëvizja paqësore e Presidentit historik Dr.Ibrahim Rugova, demonstratat e të gjitha periudhave 1968, 1981, 1989-1998, rezistenca dhe të rënët gjatë Luftës së Parë dhe të Dytë Botërore, Lëvizja Nacional Demokratike Shqiptare, të rënët gjatë Aksionit të mbledhjes së armëve, anëtarët e grupeve kaçake e lëvizjet e tjera ilegale, pastaj shumë e shumë lëvizje e ngjarje të tjera të historisë sonë, janë vlerë e jona e një rrugëtimi të përbashkët”*, dhe natyrshëm që Dr.Samet Dalipi, ka dal me suksese që të i përmbahet faktit se gjitha ngjarjet e historisë së Kosovës, e posaçërisht ato të periudhës 1989-1999, janë rrugëtimi i yni i përbashkët dhe i takojnë faqeve me të shndritshëm të historisë sonë kombëtare.

Shkodran IMERAJ